

**Lutjes për lëshimin ose vazhdimin e lejes për qëndrim të përkohshëm të huajit, i cili e ka statusin e rezidentit për kohë të gjatë në një shtet tjetër anëtar të Unionit evropian dhe se në Republikën e Sllovenisë do të qëndroi për shkak të studimit ose arsyeve tjera të bazuara, duhet bashkëlidhur:**

- fotografinë e të huajit ose numrin referues nga deponimi elektronik i fotografive;
- pasaportën ose fotokopjen e verifikuar të pasaportës së të huajit;
- dëshminë për sigurimin shëndetësor adekuat, i cili mbulon së paku shërbimet shëndetësore emergjente në Republikën e Sllovenisë, kur i huaji thekson, se në Republikën e Sllovenisë nuk posedon sigurimin e detyrueshëm shëndetësor;
- dëshminë për mjete të mjaftueshme për mbijetesë;
- vërtetimin nga evidenca penale të shtetit amë të huajit gjithmonë në rastin e lutjes për lëshimin e lejes së parë, kurse në rastet tjera, nëse organi kështu kërkon.

**Në rastin e lutjes për lëshimin ose vazhdimin e lejes për qëndrim të përkohshëm për shkak të studimit**

- dëshminë mbi pranimin në arsimim publik të validshëm ose programin studimor përkatësisht dëshminë mbi kryerjen e arsimimit profesional, specializimit ose aftësimin praktik, të cilin e lëshon organizata arsimore, në të cilën i huaji është i pranuar, përkatësisht vërtetimin mbi pranimin të organit shtetërorë kompetent, i cili është kompetent për zbatimin e kontratës ndërkombëtare ose është dhënësi i bursës, përkatësisht vërtetimin mbi pranimin, të cilin e lëshon organizata e autorizuar nga ana e shtetit, i cili është përgjegjës për zbatimin e një programi të caktuar.

**Në rastin e lutjes për lëshimin ose vazhdimin e lejes për qëndrim të përkohshëm për shkak të tjera të bazuara**

- dëshmitë mbi bazueshmërinë e qëndrimit në Republikën e Sllovenisë.

**Në procedurën njësia administrative sipas detyrës zyrtare do ti siguroi të dhënat në vijim:**

- mbi sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Sllovenisë, kur i huaji me rastin e dëshimit të sigurimit shëndetësor thekson, se në Republikën e Sllovenisë ka sigurimin e detyruar shëndetësor;
- nga evidenca penale, evidenca e aktgjykimeve të plotfuqishme përkatësisht aktvendimeve për kundërvajtjet, të cilat në Republikën e Sllovenisë i mbanë Ministria e drejtësisë;
- nga evidencat për vendimet e plotfuqishme të kundërvajtjeve, të cilat i mbajnë organet për kundërvajtje në Republikën e Sllovenisë;
- mbi aktakuzat e plotfuqishme të depozituara dhe aktgjykimet e jo plotfuqishme të lëshuara, të cilat i mbanë gjykata kompetente;
- nga evidencat, të cilat i mban organi tatimor mbi detyrimet tatimore të jopaguara të skaduar dhe mbi kundërvajtjet tatimore, të cilat janë të shënuara si sekret tatimor.

**Informata lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale:**

- të dhënat personale nga formulari për qëllim të lëshimit të lejes për qëndrim përpunohen në ujdi me nenin 93. të Ligjit për të huajit;
- organi ka të drejtë që të përfitoi edhe të dhëna tjera, nëse kjo është në interesin tuaj dhe se

për këtë e keni dhënë pëlqimin ose nëse kjo është e lejuar me ligj, pëlqimin mund ta revokoni kurdoherë pranë organit;

- nëse për këtë janë plotësuar kushtet e parashkuara, keni të drejtë ndaj informimit me të dhënat tuaja personale, të drejtën ndaj përkufizimit të përpunimit dhe të drejtën ndaj kundërshtimit të përpunimit;
- keni të drejtë që të verifikoni saktësinë e të dhënave tuaja personale, të shënuara në lejen për qëndrim, dhe të drejtën që të kërkonti ndryshimin e tyre ose, nëse për këtë janë të plotësuar kushtet e parashkuara, fshirjen e tyre;
- menaxhuesi i ruan të dhënat tuaja në ujdi me nenin 115. të Ligjit për të huajt;
- kontakti i personit të autorizuar të menaxhuesit për mbrojtjen e të dhënave personale në Ministrinë e punëve të brendshme: posta elektronike: [dpo.mnz@gov.si](mailto:dpo.mnz@gov.si);
- nëse jeni të mendimit, se të dhënat tuaja po përpunohen joligjshëm, mund të ushtroni ankesë pranë Autorizuesit të informimit.